

VENDIM
Nr.691, datë 13.8.2010

**PËR NJË PËRJASHTIM NGA VENDIMI NR.53, DATË 21.1.2009 I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN
E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Përfashtimisht nga përcaktimi i vendimit nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, për vitin kalendarik 2010, procedura e prokurimit për blerje letër offset për shtypjen e Fletores Zyrtare të kryhet nga vetë Qendra e Publikimeve Zyrtare, si autoriteti kontraktor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha